FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

METIL DOPA

Tableta - 250 mg
(Metildopa)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:
1. Çfarë është Metil dopa dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Metil dopa
3. Si ta merrni Metil dopa
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Metil dopa
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË METIL DOPA DHE PËRSE PËRDORET

Mekanizmi i veprimit të metildopës ende nuk është përcaktuar plotësisht, por ka të ngjarë që ai të lidhet me metabolizmin e këtij bari në alfa – metilnoradrenalinë e cila ul presionin arterial duke nxitur receptorët alfa – adrenergjikë që janë frenues qendrorë. Ajo jep një neurotransmetim falls dhe ul veprimtarinë e reninës plazmatike.
Metil dopa – tabletë 250 mg indikohet në mjekimin e hipertensionit.

2. PËRPARA SE TË MERRNI METIL DOPA

Mos merrni Metil dopa nëse keni:
- mbindjeshmëri të njohur ndaj metildopës ose përbërësve të tjerë të tabletës;
- sëmundje aktive të mëlçisë ose të dhëna të mëparshme për sëmundje të tilla;
- të dhëna për depresion;
- feokromocitomë;
- porfiri.

Tregoni kujdes të veçantë me Metil dopa
Gjatë mjekimit me metildopa, në 20% të të sëmurëve mund të shfaqet një rezultat pozitiv i provës së Kumbsit. Në këto raste mjeku duhet të përcaktojë nëse ekziston anemi hemolitike apo kjo provë është interferencë nga Metil dopa.
Doza fillestare e metildopës duhet ulur në të sëmurët me dëmtime të funksionit të veshkave.
Gjatë mjekimit këshillohet që të bëhen analizat e gjakut dhe provat e funksionit të mëlçisë.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Metil dopa.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Metil dopa në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke u trajtuar me:
- antihipertensivë të tjerë (theksohet efekti hipotensiv);
- antipsikotikë (theksohet efekti hipotensiv dhe rritet risku për efekte ekstrapiramidale);
- anksiolitikë dhe hipnotikë (theksohet efekti hipotensiv);
- ß- bllokues (theksohet efekti hipotensiv);
- kortikosteroidë (antagonizojnë efektin hipotensiv të metildopës);
- levodopa (theksohet efekti hipotensiv);
- karbonat litiumi (ka rrezik për neurotoksicitet);
- ß2 - simpatomimetikë (rrezik hipotensioni);
- sulfat hekuri (ferroz) i marrë nga goja (antagonizon efektin hipotensiv të metildopës);
- antiinflamatorë josteroidë (antagonizojnë efektin hipotensiv të metildopës);
- estrogjenë (antagonizojnë efektin hipotensiv të metildopës).

Marrja e Metil dopa me ushqim dhe pije
Marrja e alkoolit njëkohësisht me këtë bar thekson efektin hipotensiv.

Shtatzënia
Metildopa përdoret në mënyrë të zakonshme në kontrollin e hipertensionit gjatë shtatzënisë. Ka pak evidenca për efekte anësore në zhvillimin fetal. Megjithatë, ky bar e kalon placentën.

Ushqimi me gji
Metildopa shpërndahet në qumështin e gjirit në sasi të vogla, të cilat konsiderohen si jo të dëmshme për fëmijën.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Metildopa mund të shkaktojë sedacion dhe të dëmtojë aftësitë e të sëmurit për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Metil dopa
Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI METIL DOPA

Gjithmonë merrini tabletat Metil dopa vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Metil dopa janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Dozimi është si vijon:
Në fillim përdoren 250 mg, 2 – 3 herë në ditë, për 2 ditë. Pastaj doza rritet gradualisht në intervale jo më pak se 2-ditore, derisa të arrihet rezultati i duhur klinik. Doza maksimale është 3 g. Për të minimizuar efektin qetësues, rritja e dozës fillohet në mbrëmje.
Doza më të vogla mund të përdoren duke e kombinuar metildopën me një diuretik tiazidik (p.sh. 500 mg metildopa + 50 mg hidroklortiazid, një herë në ditë).

Në qoftë se keni marrë më shumë Metil dopa
Në qoftë se keni marrë më shumë Metil dopa se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Metil dopa
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Metil dopa mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze dhe herë të tjera jo.
Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore!
Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë:
- përgjumja, kryesisht në fillim të trajtimit dhe në rast se rritet doza. Marramendja dhe trullosja mund të shoqërohen me hipotension ortostatik, nauze, dhimbje koke, dobësi dhe lodhje;
- efektet mendore dhe neurologjike të metildopës përfshijnë: dëmtim të përqëndrimit dhe të kujtesës, psikoza të lehta, depresion, gjumë të shqetësuar dhe makthe, parestezi, paralizë faciale, lëvizje të pavullnetshme koreoatetike dhe parkinsonizëm;
- shpesh metildopa shoqërohet me mbajtje të lëngjeve dhe edema, gjendje e cila përgjigjet ndaj diuretikëve dhe rrallë mund të avancojë deri në insufiçiencë kardiake. Mund të rëndohet angina pektoris;
- shqetësime gastrointestinale, përfshirë: nauze e të vjella, diarre, konstipacion dhe rrallë pankreatit dhe kolit. Tharja e gojës është e zakonshme, por ka ndodhur edhe nxirje e gjuhës ose inflamacion i gjendrave të pështymës;
- në 10-20 % të pacientëve me trajtim të zgjatur mund të rezultojë pozitiv testi i Kumbsit, por vetëm një pjesë e vogël zhvillon anemi hemolitike. Ka ndodhur trombocitopeni dhe leukopeni, në mënyrë të dukshme granulocitopeni, të cilat kërkojnë ndërprerje të menjëhershme të barit.

Efekte të tjera mbindjeshmërie përfshijnë: miokardit, temperaturë, eozinofili, shqetësime të funksionit të mëlçisë, rash, erupsione granulomatoze dhe likenoide, nekrolizë toksike epidermale, sindrom i ngjashëm me gripin (temperaturë, mialgji dhe artralgji e lehtë), nokturi, uremi, kongjestion nazal dhe fibrozë retroperitoneale. Hiperprolaktinemia mund të ndodhë, me zmadhimin e gjirit apo gjinekomasti, galaktorre, dhe amenorre.
Në 2-3 muajt e parë të terapisë mund të shfaqet hepatit, por përgjithësisht është i rikthyeshëm me ndërprerjen e barit. Megjithatë, ka ndodhur edhe nekrozë hepatike fatale.
Në disa raste, Metil dopa mund të shkaktojë errësim të urinës kur ajo ekspozohet në ajër, për shkak të shkatërrimit të barit ose metabolitëve të tij.
Ka patur raportime të herëpashershme për libido të ulur dhe impotencë.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI METIL DOPA

Mbajeni barin larg fëmijëve!
Mos e përdorni Metil dopa pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim!
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Metil dopa – Tableta 250 mg
Lënda vepruese është metildopa.
Çdo tabletë përmban 250 mg metildopa.
Përbërësit e tjerë: celulozë mikrokristalore, laktozë, stearat magnezi, dioksid silici koloidal dhe talk.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 30 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00355 4 2362800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Mars 2011.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.